

VENDIM
Nr.445, datë 27.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 500, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË
PAGAVE TË PUNONJËSVE TË AVOKATIT TË POPULLIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.500, datë 18.7.2003, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Në pikën 2, vlera “11 000 lekë” bëhet me “12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë”.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e politikës së pagave, të miratuar për vitin 2009.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Klasa	Emërtimi	Paga mujore			
		Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHK)	Shtesa për kualifikim (SHP)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
I-a	Sekretar i Përgjithshëm	12 000	2%		126 000
II-a	Ndihmëskomisioner, kategoria e parë	12 000	2%		105 000
II-b	Ndihmëskomisioner, kategoria e dytë Drejtore	12 000	2%		88 000
III-a	Përgjegjës sektori	12 000	2%		69 000
IV-b	Specialist	12 000	2%		31 000